

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaSeal®-105 H

LLAÇ PËR HIDROIZOLIM ME 2 PËRBËRËS DHE I MODIFIKUAR ME POLIMERE



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaSeal®-105 H është llaç çimentoje me 2 përbërës dhe i modifikuar me polimere për shumë përdorime dhe bllokues poresh për aplikime hidroizolimi në mjedise të jashtme dhe të brendshme.

PËRDORIMET

- Hidroizolim në mjedise të brendshme e të jashtme i betonit, mureve me tulla dhe blloqe
- Hidroizolim i bazamenteve, qilareve, mureve me faqe nga dheu, rezervuarëve, etj.
- Hidroizolim i ngurtë i mureve të bazamenteve në ndërtime të reja dhe rikonstruksione

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Hidroizolim efikas dhe për shumë përdorime
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresa të ndryshme (beton, gur, mure, etj.)
- Mund të aplikohet me mallë ose furçë (në varësi të raportit të përzierjes A:B)
- Llaç gati për përdorim: përbërësit A+B pa shtim uji

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Përbërësi A: polimer i lëngshëm dhe aditiv Përbërësi B: çimento, agregate të përzgjedhura dhe aditivë
Ambalazhi	njësi 25 kg (thes 20 kg dhe kovë 5 kg)
Paraqitja / Ngjyra	Përbërësi A: lëng i bardhë Përbërësi B: pluhur gri
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor. Përbërësi i lëngët duhet të mbrohet nga ngrica.
Dendësia	(Miksi A+B): ~ 1.9 kg/l (dendësia e llaçit të freskët)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	≥ 30,0 N/mm ²	(EN 196-1)
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	≥ 6,0 N/mm ²	(EN 196-1)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	≥ 1,0 N/mm ²	(EN 1542)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Përdorim i llaç i hollë (slurry): A : B = 1 : 4 (pjesë për peshë) Përdorim si llaç: A : B = 1 : 4.5 - 5 (pjesë për peshë)
Konsumimi	Në varësi të ashpërsisë së nënshtresës, profilit të sipërfaqes dhe trashësisë së shtresës së aplikuar. Sa për udhëzim, ~1.9 kg/m ² /mm (përjashtohen firoja, mbushja e mëparshme e sipërfaqes dhe poroziteti, etj.).
Trashësia e shtresës	Maksimumi i trashësisë totale për aplikim: 4 mm Maksimumi i trashësisë së shtresës: 2 mm Minimumi dy shtresa për aplikim
Temperatura e mjedisit	+8°C min. / +35°C max.
Temperatura e nënshtresës	+8°C min. / +35°C max.
Koha e punueshmërisë	~30 minuta (në +20°C)
Koha e pritjes / mbiveshja	Koha e pritjes midis shtresave: 2 orë

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme dhe pa pluhur, papastërti, grimca të lira, ndotës sipërfaqësorë si vaj ose graso ose kore çimentoje. Nënshtresa duhet të përgatitet me teknika të përshtatshme mekanike, si uji me presion të lartë (400 bar) ose me rrymë rëre/ currila uji, ndërsa për të hequr të gjitha shtresat e mëparshme, fërkim me furçë. Smerilizoni dhe bluani pllakat qeramike ekzistuese, etj. për të larguar veshjet, bojërat, grason, ndryshkun, disarmantët, koren e çimentos dhe produktet e tjera që mund të reduktojnë ndërkapjen. Pluhuri duhet larguar me një fshesë thithëse elektrike. Nëse nevojitet, riparoni betonin e dëmtuar, shpetëzuar ose të dobët me serinë e llaçeve për riparime Sika MonoTop®, SikaRep®.

Lëmoni të gjitha qoshet ose variacionet e profileve të mprehta (ndërlidhje dyshemeje dhe muri, etj.) duke i dhënë formë të lugët, me llaçet nga seria Sika MonoTop®, për të përmirësuar efikasitetin e aplikimit. Lagni sipërfaqen deri në ngopje. Shmangni ujërat e mbledhur ose ujin e kondensuar mbi sipërfaqe përpara aplikimit (sipërfaqja duhet të ketë pamje mat të errët). Fugat e betonit, depërtimet e tubacioneve dhe të gjitha llojet e ndërprerjeve në ndërtim duhet të mbyllen dhe hidroizolohen, duke përdorur sistemin Sikadur® Combiflex® SG, produkte nga seria SikaSwell® ose produkte të tjera të përshtatshme.

PËRZIERJA

Hidhni përb. A (lëngun) në raportin e saktë brenda një konteineri të përshtatshëm për përzierje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni pluhurin brenda lëngut. Përzieni me mikser elektrik dore me shpejtësi të ulët (<500 rpm) për të shmangur bllokimin e ajrit. Përzieni plotësisht për të paktën 3 min. derisa të arrihet konsistenca e kërkuar homogjene dhe pa kokrriza. Për rezultate më të mira, përzieni të gjithë thesin. Mos i përdorni të dy përbërësit veçmas (p.sh pa i përzierë).

APLIKIMI

Aplikoni SikaSeal®-105 H me:

- mallë
- furçë

Aplikim me mallë:

Aplikoni shtresën e parë me një mallë të dhembëzuar, duke ushtruar presion të barabartë tek nënshtresa për të arritur një trashësi të rregullt dhe konsistente. Sapo të jetë ngurtësuar shtresa e parë, aplikoni shtresën e dytë me një mallë të sheshtë, duke u kujdesur për të arritur një shtresë të njëtrajtshme e të vazhdueshme.

Aplikim me furçë:

SikaSeal®-105 H mund të aplikohet me një furçë të sheshtë ose me qime të buta, të paktën në dy shtresa dhe 2 drejtime (aplikim vertikalisht dhe horizontalisht). Çdo shtresë e rradhës duhet të aplikohet sapo shtresa e mëparshme të jetë mpiksur (dmth të jetë e fortë në prekje me thoin e gishtit).

METODA E MATURIMIT

Mbroni materialin e freskët nga tharja e parakohshme (të paktën për 24 orë) duke përdorur një metodë të përshtatshme trajtimi p.sh. membranë lagështie gjeotekstili, fletë polietileni, etj.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga mjetet dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaSeal®-105 H

Mars 2019, Botimi 02.01

020701010020000090

SikaSeal-105H-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf